



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCIVE

MINISTRI

UDHEZIM

Nr. 36 , Date 10/8/2009

PER

**HARTIMIN E REGJISTRIT TE BORXHIT SHTETEROR DHE GARANCIVE
SHTETERORE TE HUASE**

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes dhe ne zbatim te ligjit Nr. 9665, date 18.12.2006 "Per huamarrjen shteterore, borxhin shteteror dhe garancite shteterore te huase ne Republiken e Shqiperise", Ministri i Financave

UDHEZON:

Neni 1
Objekti

Objekt i ketij udhezimi jane procedurat per hartimin dhe publikimin e regjistrit te borxhit shteteror dhe regjistrit te garancive shteterore te huase.

Neni 2
Percaktime

- Borxh shteteror eshte shuma e pergjithshme e borxhit te shtetit, e emetuar ne monedhen kombetare dhe/ose ne nje monedhe zyrtare te ndryshme nga monedha kombetare, i cili nuk perfshin detyrimet financiare te qeverisjes vendore.

- Garancia shtetërore e huase është marreveshja e lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e paleve, kushtet dhe menyrat sipas të cilave shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarresi, kur ai nuk arrin t'i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur.
- Kredi – janë të ardhura që merren me kusht kthimi, me ose pa interes, për financimin e projekteve të caktuara ose për financimin e deficitit buxhetor, që jepen nga qeveri të huaja ose institucione financiare vendase apo të huaja, mbi bazën e marreveshjeve perkatese që perdoren, shërbejnë dhe shlyhen në përputhje me termat dhe kushtet e këtyre marreveshjeve.
- Titujt e shtetit janë instrumentet e borxhit shtetëror, të emetuara sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga Ministri i Financave.

Neni 3

Rregjistri i Borxhit shtetëror dhe i garancive shtetërore të huase

Rregjistri i borxhit shtetëror dhe ai i garancive shtetërore të huase krijohen dhe përditesohen nga Ministria e Financave. Ata publikohen një herë në tre muaj në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

Neni 4

Përmbajtja e regjistrit të borxhit shtetëror

Rregjistri i borxhit shtetëror përmban të dhëna për borxhin shtetëror të emetuar në formën e marreveshjeve të huase dhe borxhin në formën e titujve të shtetit. Të dhënat që mbahen në regjister janë:

A. Për borxhin në formën e marreveshjeve të huase

- Numri identifikues i huase
- Kreditori
- Qëllimi i huase (emri i projektit për të cilin është marre huaja)
- Data e nënshkrimit të marreveshjes
- Monedha
- Shuma e huase sipas marreveshjes
- Stoku në një datë të dhënë në monedhën origjinale
- Data e fillimit të shlyerjes dhe data e përfundimit
- Njesia zbatuese e projektit që financohet me këtë hua

B. Për borxhin të emetuar në formën e titujve të shtetit

- Datën e emetimit
- Datën e maturimit
- Përqindjen e kuponit
- Datat e pagesës së kuponit

- Stokun
- Monedhen
- Ndryshimet e shumës gjatë periudhës (nese ka)

Neni 5

Permbajtja e regjistrit të garancive shtetërore të huasë

Regjistri i garancive shtetërore të huasë përmban:

- Numri identifikues i huasë
- Kreditori
- Qëllimi i huasë (emri i projektit për të cilin është marrë huaja)
- Data e nënshkrimit të marrëveshjes
- Monedha
- Shuma e huasë sipas marrëveshjes
- Stoku në një datë të dhënë në monedhën origjinale
- Data e fillimit të shlyerjes dhe data e përfundimit
- Njesia zbatuese e projektit që financohet me këtë hua/huamarrësi

Për zbatimin e këtij Udhezimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit.

Ridvan BODE

MINISTER

